



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr.345/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit N.P.T. “FAT-OIL”, me seli në fshatin Xërxë, Komuna e Rahovecit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Bajram Morina, avokat nga Gjakova, kundër të paditurës Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti anulimi i vendimit Nr. 35/2020 i datës 06.05.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik më datë 03.04.2024, me pjesëmarrje të përfaqësuesit të paditësit sipas autorizimit avokat Bajram Morina, ndërsa në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur sipas autorizimit, më datë 15.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit N.P.T. “FAT-OIL”, me seli në fshatin Xërxë, Komuna e Rahovecit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Bajram Morina, avokat nga Gjakova, kundër të paditurës **AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS**, me seli në Prishtinë, me çka ka kërkuar anulimin e vendimit Nr. 35/2020 i datës 06.05.2020, **si e pabazuar**.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Historiku procedural

1. Më datë 18.05.2020, në Gjykatën Themelore të Prishtinës-Departamenti për Çështje Administrative, paditësi N.P.T. “FAT-OIL”, me seli në me seli në fshatin Xërxë, Komuna e Rahovecit, ka parashtruar padi e evidentuar me nr. A.nr. 863/2020, kundër

të paditurit Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, tutje AKK, me seli në Prishtinë për shkak të anulimit të anulimi i vendimit Nr. 35/2020 i datës 06.05.2020, i të paditurës AKK, me propozim që të aprovohet në tërësi si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit, kurse vendimi i Komisionit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës Nr. 35/2020 i datës 06.05.2020, të prishet dhe ndryshohet në dobi të paditësit, ashtu që paditësi të lirohet nga detyrimi për të paguar gjobën-masën ndëshkuese administrative, në shumë të përgjithshme prej 101,169.91 euro.

2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA.nr. 345/22.
3. Më datë 03.04.2024 Gjykata caktoi dhe mbajti seancë të shqyrtimit kryesor publik me pjesëmarrje të përfaqësuesit të paditësit avokat Bajram Morina, sipas autorizimit të datës 12.05.2020, ndërsa në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, konform nenit 41 të LKA-së, të ftuar në mënyrë të rregullt, e paditura për datën dhe kohën e mbajtjes së seancës është njoftuar në procesverbal të datës 04.03.2024.

Pretendimet e paditësit

4. Përfaqësuesi i paditësit në padi, në pretendimet e dhëna gjatë shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e paditura sipas Konkluzionit Nr. 401/19, me Nr. te Protokollit: 40/19-02/D, i datës 15.02.2019, ka filluar procedurën hetimore ndaj paditësit dhe 15 operatorëve të tjerë ekonomik, bazuar gjëja në shqetësimet e ngritura nga opinioni publik, përmes mediave dhe Shoqërisë civile, dhe se gjeja paditësi dhe 15 operatorët tjerë ekonomike kanë pasur Marrëveshje të ndaluar apo praktike të bashkërenduar në mes të ndërmarrjeve të cilat merren me tregtimin e Naftës dhe derivateve të naftës, kurse me Njoftimin për faktet paraprake të konstatuara në procedurën paraprake, Nr. 369/19-07/D, i datës 21.11.2019, e ka njoftuar paditësin për: faktet e konstatuara në procedurën paraprake bazuar në dokumentacionin e siguruara nga Dogana e Kosovës, ATK-se dhe paditësi, për shkeljet ligjore të pretenduara nga i

padituri, si dhe e ka udhëzuar paditësin se ka te drejt te jep komente-përgjigje në këtë njoftim.

5. Ka theksuar se Lidhur me Njoftimin e te paditurit, Nr. 369/19-07/D, te datës 21.11.2019, paditësi pas shqyrtimit dhe analizës se këtij njoftimi, përmes parashtresës te tij te datës 18.12.2019, ka njoftuar te paditurën se pretendimet ne Njoftimin kontestues për shkeljet ligjore dhe gjendja faktike paraprake e precizuar ne këtë Njoftim, janë ne tërësi te pabazuara, kështu që përmes parashtresës ka kërkuar nga i padituri qe te pushoj hetimet ndaj paditësit sipas Konkluzionit te lartpërmendur, bazuar ne faktin jokontestues se: Paditësi, si pjesëmarrës ne tregun e shitjes se Benzinës me 1,07 % , dhe si pjesëmarrës në tregun e shitjes se Naftës me 0.96 % , te precizuar ne pikën II/1 ne faqen 2 të Njoftimit te paditurit te datës 21.11.2019, nuk ka pasur, e as që ka mundësi që të çrregulloj tregun për shitjen e Benzinës dhe Naftës, siç ka theksuar gabimisht dhe pa baze ligjore ne Njoftimin e lartpërmendur, paditësi nuk ka lidhur asnjë Marrëveshje (te definuar me dispozitat e nenit 3, par.. 1, nen par. 1.1 te Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës) te ndaluar me ndonjë subjekt tjetër ekonomik (Ndërmarrje), sipas dispozitave të nenit 4, par. 1 te Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, respektivisht nuk ka marre pjesë ne marrjen e ndonjë vendimi përmes Shoqatës, nuk ka bashkërenditur praktikat me subjektet tjera për te ndikuar me qellim, ose qe te ndikoj ne mënyrë të dukshme ne çrregullimin e konkurrencës tregtare ne tregun relevant, dhe nuk ka ndërmarrë asnjë veprim, për te caktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë çmimet e blerjes ose te shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi te Benzinës dhe Naftës, me çka paditësi ka vërtetuar se nuk ka cënuar dispozitat e nenit 4, par. 1, e lidhur me nën par. 1.1 te Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, siç ka theksuar gabimisht dhe pa baze ligjore ne Njoftimin e lartpërmendur.
6. Ka shtuar se në baze te parametrave dhe të dhënave te konstatuara në Njoftimin e lartpërmendur te Autoritetit Kosovar te Konkurrencës, paditësi, si pjesëmarrës ne tregun e shitjes Benzinës me 1,07 % , dhe si pjesëmarrës ne tregun e shitjes se Naftës me 0.96 % , nuk mund te konsiderohet se ka pozite dominuese në treg, të definuar sipas

dispozitave te nenit 10, te Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi me dispozitat e par. 2 te këtij është përcaktuar se "Një ndërmarrje konsiderohet te ketë pozite dominuese nëse ka pjesëmarrje me te madhe se dyzet përqind (40%) ne treg", bazuar ne faktin jokontestues se vet i padituri Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ne njoftim ka konstatuar se paditësi merrë pjese ne tregun për shitjen e Benzinës me 1,07 % , kurse me shitjen e Naftës me 0.96 % , me çka vërtetohet se paditësi nuk ka pasur as mundësi teorike qe te abuzoj me pozitën dominuese ne treg, siç ka theksuar gabimisht dhe pa baze ligjore ne njoftimin e lartpërmendur, dhe se paditësi, objektivisht nuk ka pasur si te abuzoj me Pozite dominues ne treg, pasi nuk ka disponuar me një pozite te tille, për shkaqet e përmendura ne pikën 1, 2 dhe 3 te kësaj parashtrere, me çka po ashtu vërtetohet se paditësi, nuk ka cënuar dispozitat e nenit 11 te Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, siç ka konstatuat gabimisht dhe pa bazë ligjore Autoriteti Kosovar i Konkurrencës në njoftimin e tij. Më datë 11.02.2020, është mbajtur seancë dëgjimore në selinë e të paditurit, ku i padituri gjatë seancës është tërhequr nga pretendimi lidhur me abuzimin e pozitës dominuese në treg të paditësit dhe ka pranuar faktin se paditësi nuk ka abuzuar me pozitën dominuese në treg, mirëpo prape ka mbetur pran pretendimit të tij se paditësi gjatë muajit Nëntor dhe Dhjetor të vitit 2018 ka çrregulluar konkurrencën tregtare dhe se me këtë çrregullim ka kryer shkelje të nenit 4 par 1 nën par. 1.1 të Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, me arsyetim se paditësi ka lidhur marrëveshje të ndaluar apo ka zbatuar praktikë të bashkërenduar, kështu që me vendimin e atakuar me padi e ka ndëshkuar paditësin me gjobë në shumë prej 101,169.91 euro.

7. Ka deklaruar se nga arsyetimi i vendimit, vërtetohet se i padituri nuk ka vendosur në mënyrë meritore lidhur me pretendimet e paditësit, të përmendura në parashtrësën e datës 18.12.2019, dhe gjatë seancës dëgjimore, ngase i padituri nuk ka prezantuar asnjë provë materiale valide me të cilën do ti vërtetonte pretendimet e tij dhe se gjatë procedurës paraprake të zhvilluar pran të paditurit është vërtetuar se paditësi nuk ka lidhur asnjë marrëveshje të ndaluar me ndonjë subjekt tjetër ekonomik sipas dispozitave të nenit 4 par 1 të Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës respektivisht nuk ka marr pjesë në marrjen e ndonjë vendimi përmes Shoqatës, nuk ka bashkërenditur praktikat me subjektet tjera për të ndikuar me qëllim ose që të ndikoj në mënyrë të dukshme në çrregullimin e Konkurrencës tregtare në tregun relevant dhe nuk ka

ndërmarr asnjë veprim për të caktuar në mënyrë të drejtpërdrejte apo të tërthortë çmimet e blerjes ose të shitjes apo çdo kusht tjetër të tregimit të benzinës dhe naftës, nuk ka pasur marrëveshje të ndaluar me ndonjë ndërmarrje tjetër, me çka paditësi ka vërtetuar se nuk ka cenuar dispozitat e nenit 4 par1. Lidhur me nën par 1.1 të Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

8. Shkeljet e supozuara sipas të paditurit kanë ndodhur gjatë muajit nëntor dhe dhjetor të vitit 2018, kurse paditësi me vendimin e kundërshtuar me padi është detyruar që të paguaj 3% të mesatares së të hyrave të realizuar për 6 muaj (Korrik-Dhjetor 2018), për katër muaj më shumë, në vend se të merret mesatarja e të hyrave për muajin nëntor dhe dhjetor të vitit 2018. Vendimit të atakuar me padi i mungon baza ligjore dhe faktet vendimtare për refuzimin e pretendimeve të paditësit, të parashtruara përmes parashtrësës së datës 18.12.2019, është arsyetim i njëanshëm dhe se i padituri ka vepruar në kundërshtim me nenin 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, tutje pretendon se vendimi i kundërshtuar me padi ka karakter diskriminues ndaj paditësit pasi që cenon dhe shkel parimet e LPPA-së përkatësisht nenet 4, 5,6,8,9, dhe nenit 3, 119, 21 dhe 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ngase i padituri ka dështuar të përmbush obligimin e vet kushtetues që paditësit të ia siguron një mjedis të favorshëm ligjor për ekonominë e tregu lirinë e aktivitetit ekonomik dhe trajtimin e barabartë dhe pa dallim të biznesit të tij. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit, kurse vendimi i Komisionit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës Nr. 35/2020 i datës 06.05.2020, të priset dhe ndryshohet në dobi të paditësit, ashtu që paditësi të lirohet nga detyrimi për të paguar gjobën-masën ndëshkuese administrative, në shumë të përgjithshme prej 101,169.91 euro.

Kundërshtimet e të paditurës

9. Përfaqësuesi i të paditurës, në përgjigje në padi sipas parashtrësës së datës 12.02.2024 e ka kundërshtuar kërkesëpadinë si të pabazuar me arsyetim se pretendimet e palës paditëse në padi janë të pa bazuara dhe si të tilla jo relevante për palën e paditur. Objekti i marrëveshjes është monitorimi i tregut në sektorin e derivateve të naftës dhe benzinës, Vendimi i kundërshtuar është i nxjerrë për palën N.P.T. FAT OIL SH.P.K., duke përfshirë 3 njësitë, pikat e shitje sipas ARBK. Baza e provave për vendimin për të cilën

se pala paditësi thotë se ka dështuar të vërtetoj drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, respektivisht ka dështuar që me prova materiale të vërtetoj faktin dokumentacioni është siguruar nga vet N.P.T. "FAT OIL", Dogana e Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe Ministria e Financave, pra janë të pabazuara pretendimet e palës paditëse për shkelje të nenit 86 , 88, dhe 89 i LPPA-së sepse bashkëpunimi ka qenë me institucione kredibile që vështirë mund të rrëzohet besueshmëria në kompetencën e tyre. Pala paditëse në asnjë rast tek shkresat dhe dëgjimet e palës nuk sqaron dhe i ikë pyetjes se pse i ka ngritë çmimet për muajt nëntor dhe dhjetor 2018. Autoriteti KK e ka liruar paditësin nga hetimet për abuzim me pozitën dominuese, por nuk e ka liruar për ndikim apo që është ndikuar në sjellje veprime të kompanisë për rritjen e çmimeve të shitjes së derivateve naftë dhe benzinë gjatë muajve nëntor dhe dhjetor 2018.

10. Ka deklaruar se sjellja dhe veprimi i paditësit N.P.T. FAT OIL e përforcon edhe më shumë definicionin praktikë e bashkërenduar, si bashkërendim midis ndërmarrjeve të cilat pa e arrit fazën e nënshkrimit të një marrëveshje zyrtare me dijeni kryejnë bashkëpunim praktik për të shmangur rrezikun e konkurrencës. Disa tregje oligopolistike, në kushte të caktuara ndër to edhe nafta mund tu mundësojnë ndërmarrjeve të mbajnë politika të përbashkëta pa hyrë në marrëveshje ose praktikë të bashkërenduara. Ky fenomen shpesh referohet nga ekonomistët si "bashkëpunim i fshehtë i heshtur". Pretendimi i palës paditëse për shkeljet në llogaritjen e mesatares për muajt Korrik-Dhjetor 2018, nga ana e AKK janë të pa baza sepse në padinë e tyre nuk kanë paraqitur ndonjë tabelë, grafikun ose llogaritje tjetër matematikisht të saktë për të sfiduar punën e Sekretariatet të Autoritetit. Për mesataren e caktimit të gjobësmasës ndëshkuese administrative është bërë në mbështetje të nenit 56 par1, nën par1.1 si dhe nenit 59 par.2 dhe 4 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229 dhe Ligjit Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-2296 për Mbrojtjen e Konkurrencës, dhe në mbështetje të Udhëzimit Administrativ neni 3,4,8 . Meqenëse periudha e shkeljes së këtij ligji është më e shkurtër se 6 muaj Autoriteti e konsideron si gjysmë viti dhe ndëshkimi aplikohet në qarkullimin për periudhën Korrik-Dhjetor 2018, në përputhje me nenin 4 par.4 të UA nr. 01/2018.

11. Ka deklaruar se gjatë analizës dhe përpunimit të dhënave kanë vërejtur se nga muaji janar - tetor 2018 mesatarja e fitimit bruto/l ka qenë 0.08 cent/L ndërsa për muajin nëntor - dhjetor 2018 mesatarja e fitimit bruto/l ishte 0.17 cent/L. Gjate muajve janar - tetor ndërmarrjet te cilat operojnë ne tregun përkatës kane pas një dallim te çmimit shitës nga çmimi blerës mesatarisht rreth 9% fitimi bruto/l. Gjate muajit nëntor krahasuar me mesataren e muajve janar - tetor, çmimi blerës/l ka rritje për 2.0% ndërsa çmimi shitës/l krahasuar me muajt janar - tetor është rritur për 7% dhe mesatarja e fitimit bruto/l krahasuar me muajt janar - tetor është rritur për 60% ne raport me fitimin bruto/l për periudhën janar - tetor. Gjate muajit dhjetor krahasuar me mesataren e muajve janar -tetor, çmimi blerës/l ka rënie për 8% ndërsa çmimi shitës/l krahasuar me muajt janar - tetor ka rritje për 4% dhe mesatarja e fitimit bruto/l krahasuar me muajit janar - tetor është rritur për 124% në raport me periudhën e njëjte. Nga analizimi dhe përpunimi i te dhënave për produktin benzinë nga muaji janar - tetor 2018 mesatarja e fitimit bruto/l ka qenë 0.11 cent/i ndërsa për muajin nëntor - dhjetor 2018 mesatarja e fitimit bruto/i ishte 0.26 cent. Gjatë muajve janar - tetor ndërmarrjet te cilat operojnë ne tregun përkatës kanë pas një dallim te çmimit shitës nga çmimi blerës mesatarisht rreth 12% fitimi bruto. Gjate muajit nëntor krahasuar me mesataren e muajve janar - tetor, çmimi blerës ka rënie për 5.0% ndërsa çmimi shitës/l krahasuar me periudhën e njëjte është rritur për 7.0% dhe mesatarja e fitimit bruto/l krahasuar me muajt janar - tetor është rritur për 108% ne raport me fitimin bruto/l për periudhën janar - tetor. Gjate muajit dhjetor krahasuar me mesataren e muajve janar - tetor, çmimi blerës/l ka rënie për 12% ndërsa çmimi shitës/l krahasuar me muajt janar - tetor ka rritje për 4% dhe mesatarja e fitimit bruto/l krahasuar me muajit janar - tetor është rritur për 135% ne raport me periudhën e njëjte.

12. Autoriteti konstaton se ndërmarrjet te cilat operojnë ne tregun relevant (shitje me pakice - benzine) nuk kane reflektuar ne mënyrë individuale marre për bazë çmimin e shitjes dhe fitimin bruto/l për muajin nëntor dhe dhjetor, që do te thotë, se ndërmarrjet te cilat janë ne procedure hetimore, kane pasur fitimin bruto/l përafërsisht 12% për muajt janar - tetor, ndërsa për muajin nëntor, ne mënyre te bashkërenduar kane realizuar fitimin bruto/l mesatarisht 108% dhe për muajin dhjetor 135% ne raport me periudhën janar tetor . I ka propozuar gjykatës që të hedhet poshtë si e pathemeltë kërkesëpadia e paditësit të paraqitur kundër vendimit Nr. 35/20 të datës 06.05.2020 dhe të aprovoj

masën ndëshkuese administrative në shumë prej 3 %, të totalit të hyrave për 6 mujorin e vitit 2018 në vlerë prej 101,169.91 euro.

Provat e administruara

13. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Vendimi i kundërshtuar nr.35/2020 i datës 06.05.2020, Njoftimi për konstatimin e gjendjes faktike nga AKK, me datë 31.01.2020 me nr.28/20, Njoftimi i fakteve paraprake të konstatuara në procedurë me nr.369/19 i datës 21.11.2019, Komentet nga paditësi FAT OIL lidhur me njoftimin e AKK-së me nr.369/19-07/D të datës 21.11.2019, Konkluzion nga AKK me nr.0119 datë 15.02.2019, Procesverbal me datë 26.02.2020 me nr.88/20 .
14. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenin 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi, përgjigjen e të paditurës në padi, deklaratimet e tyre në seancë si dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar.
15. Në Vendimin e kundërshtuar nr.35/2020 të datës 06.05.2020, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK) ka marr vendim duke konstatuar se ndërmarrja N.P.T. “FAT OIL” ka çrregulluar konkurrencën tregtare gjatë muajve Nëntor dhe Dhjetor të vitit 2018 duke kryer shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229 përkatësisht nenit 4 “Marrëveshja e Ndaluar apo praktikë e bashkërenduar” par.1 nën par.1.1. Ndërmarrjes N.P.T. “FAT OIL”, i është shqiptuar masa ndëshkuese administrative në shumën prej 3%, të totalit të të hyrave për 6 mujorin e vitit 2018, në vlerë prej 101,169.91 euro dhe ka konstatuar se ndërmarrja N.P.T. “FAT OIL”, ndërsa ka konstatuar se nuk ka abuzuar me pozitën dominuese në treg individuale apo kolektive, përkatësisht nuk ka shkelje ligjore sipas nenit 11 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. AKK për të konstatuar marrëveshjen e ndaluar apo praktikën e bashkërenduar AKK është bazuar në nenin 3 par.1.2 si dhe në nenin 4 par1 pika 1.1 dhe

nenin 66 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Konkluzioni i heshtur, nuk do të thotë detyrimisht involvim në ndonjë marrëveshje të heshtur apo involvim i palëve për tu marrë vesh apo komunikuar. Por ju referohet marrëveshjes së heshtur, sepse rezultati mund të ngjasoj me marrëveshje eksplicite apo edhe të një karteli zyrtar. Konkluzioni apo marrëveshja e heshtur është një sjellje e tregut që u mundëson firmave të fitojnë fitime ekstra normale ku fitimet normale korrespondojnë me situatën e ekuilibrit. Marrëveshja e heshtur realizohet kur firmat bashkëveprojnë në mënyrë të heshtur. Atëherë ato mund të jenë në gjendje të ruajnë çmimet më të larta duke rënë dakord në heshtje se çdo devijim nga rruga e konkluzionit do të shkaktonte një hakmarrje.

16. Gjate analizës dhe përpunimit të dhënave për N.T.P Fat Oil, autoriteti ka konstatuar se nga muaji Janar – Tetor 2018 mesatarja e fitimit bruto për litër ka qene 0.08 cent/l, ndërsa për muajin Nentor – Dhjetor 2018 mesatarja e fitimit bruto/l ishte 0.17 cent/l. Sipas paraleles së krahasueshmerise per muajin Shkurt –Dhjetor 2018, kur në muajin shkurt çmimi blërs/l (për litër) ishte 0.92 cent/l, çmimi shites/l ishte 1.02 cent/l ndërsa fitimi bruto/l ishte 0.10 cent/l - gjë që është reflektuese me çmimin e berëzës botërorë. Ndërsa për muajin Dhjetor kur çmimi i berzes kishte rënie nga muaji paraparak dhe po ashtu çmimi importues/l ishte i njejte me muajin shkurt 2018, 0.93 cent/l, çmimi shites/l ishte 1.12 cent/l ndërsa fitimi bruto/l për muajin Dhjetor 2018 ishte 0.19 cent/l, dhe gjë që ndërmarrja FAT OIL Sh.P.K nuk ka reflektuar me ulje të çmimit karshi çmimit të berzes dhe çmimit importues.
17. Nga rezulton se në mënyrë të bashkërenduar me ndërmarrjet që operojnë në tregun e naftës kanë caktuar çmimin shitës në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-229 dhe plotësim ndryshimi i tij nr. 04/L-226, për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse të gjitha ndërmarrjet për produktin naftë nga muaji janar - tetor 2018 mesatarja e fitimit bruto/l ka qenë 0.08 cent/l ndërsa për muajin nëntor - dhjetor 2018 mesatarja e fitimit bruto/l ishte 0.17 cent/l. Gjate muajve janar - tetor ndërmarrjet të cilat operojnë në tregun përkatës kanë pas një dallim të çmimit shitës nga çmimi blerës mesatarisht rreth 9% fitimi bruto/l. Gjate muajit nëntor krahasuar me mesataren e muajve janar - tetor, çmimi blerës/l ka rritje për 2.0% ndërsa çmimi shitës/l krahasuar me muajt janar - tetor është rritur për 7% dhe mesatarja e fitimit bruto/l krahasuar me muajt janar - tetor është rritur për 60% në raport me fitimin bruto/l për periudhën janar - tetor. Gjate muajit dhjetor krahasuar me mesataren e muajve janar -tetor, çmimi blerës/l ka rënie për 8%

ndërsa çmimi shitës/l krahasuar me muajt janar - tetor ka rritje për 4% dhe mesatarja e fitimit bruto/l krahasuar me muajt janar - tetor është rritur për 124% në raport me periudhën e njëjte. AKK konstaton se ndërmarrjet të cilat operojnë në tregun relevant nuk kanë reflektuar në mënyrë individuale marrë për bazë çmimin e shitjes dhe fitimin bruto për Muajin Nëntor dhe Dhjetor Kanë pasur fitim bruto përafërsisht 9%, për muajt Janar-Tetor, ndërsa për muajin nëntor, në mënyrë të bashkërenduar kanë realizuar fitimin bruto mesatarisht 60%, edhe për muajin dhjetor 124% në raport me periudhën Janar-Tetor.

18. Ndërsa për produktin e benzinës nga muaji Janar – Tetor 2018 mesatarja e fitimit bruto për litër ka qene 0.11 cent/l, ndërsa për muajin Nentor – Dhjetor 2018 mesatarja e fitimit bruto/l ishte 0.26 cent/l. Sipas paraleles së krahasueshmerise per muajin Shkurt – Dhjetor 2018, kur në muajin shkurt çmimi blërs/l (për litër) ishte 0.93 cent/l, ndersa fitimi bruto/l ishte 0.14 cent/l gje qe ishte reflektuese me çmimin e berzes boterore, ndërsa për muajin Dhjetor kur çmimi i berzes kishte rënie dhe po ashtu çmimi importues/l ishte me i ulte se muajt paraprak, 0.87 cent/l, çmimi shitës/l ishte 1.14 cent/l, ndërsa fitimi bruto/l për muajin Dhjetor ishte 0.28 cent/l, gjë qe ndërmarrja FAT OIL Sh.p.k nuk ka reflektuar me ulje te fitimit bruto/l karshi uljes se çmimit te berzes dhe çmimit importues.

19. Nga rezulton se në mënyre të bashkërenduar me ndërmarrjet që operojn në tregun e naftës kanë caktuar çmimin shitës dhe në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1.1 te Ligjit nr. 03/L-229 dhe plotësim ndryshimi i tij nr. 04/L-226, për Mbrojtjen e Konkurrencës. Llogaritjet për produktin benzinë sipas te dhënave vërehet se ndërmarrjet nga muaji janar - tetor 2018 mesatarja e fitimit bruto/l ka qenë 0.11 cent/i ndërsa për muajin nëntor - dhjetor 2018 mesatarja e fitimit bruto/i ishte 0.26 cent. Gjatë muajve janar - tetor ndërmarrjet te cilat operojnë ne tregun përkatës kanë pas një dallim te çmimit shitës nga çmimi blerës mesatarisht rreth 12% fitimi bruto/. Gjate muajit Nëntor krahasuar me mesataren e muajve janar - tetor, çmimi blerës ka rënie për 5.0% ndërsa çmimi shitës/l krahasuar me periudhën e njëjte është rritur për 7.0% dhe mesatarja e fitimit bruto/l krahasuar me muajt janar - tetor është rritur për 108% ne raport me fitimin bruto/l për periudhën janar - tetor. Gjatë muajit dhjetor krahasuar me mesataren e muajve janar - tetor, çmimi blerës/l ka rënie për 12% ndërsa çmimi shitës/l krahasuar me muajt janar - tetor ka rritje për 4% dhe mesatarja e fitimit bruto/l krahasuar me

muajit janar - tetor është rritur për 135% ne raport me periudhën e njëjte. autoriteti konstaton se ndërmarrjet te cilat operojnë ne tregun relevant (shitje me pakice - benzine) nuk kane reflektuar ne mënyrë individuale marre për bazë çmimin e shitjes dhe fitimin bruto/i për muajin nëntor dhe dhjetor, që do te thotë, se ndërmarrjet te cilat janë ne procedure hetimore, kane pasur fitimin bruto/ l përfaqësisht 12% për muajt janar - tetor, ndërsa për muajin nëntor, ne mënyre te bashkërenduar kane realizuar fitimin bruto/l mesatarisht 108% dhe për muajin dhjetor 135% ne raport me periudhën Janar-Tetor . Për mesataren e caktimit të gjobës-masës ndëshkuese administrative është bërë në mbështetje të nenit 56 par1, nën par1.1 si dhe nenit 59 par.2 dhe 4 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229 dhe Ligjit Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-2296 për Mbrojtjen e Konkurrencës, dhe në mbështetje të Udhëzimit Administrativ 01/2018 neni 3,4,8. Rasti i derivateve është për vitin 2018, ndërsa shkelja është konstatuar për muajt Nëntor dhe Dhjetor 2018. Meqenëse periodha e shkeljes së këtij ligji është më e shkurtër se 6 muaj Autoriteti e konsideron si gjysmë viti dhe ndëshkimi aplikohet në qarkullimin për periudhën Korrik-Dhjetor 2018, në përputhje me nenin 4 par. 4 të UA nr.01/2018.Baza e ndëshkimit është 3,372,330.19 euro. AKK aplikon normën 3% në këtë bazë të ndëshkimit, ku në total 101,169.91 euro, dhe ka aplikuar dispozitat lehtësuese duke e marr për bazë bashkëpunimin e palës. Sipas Procesverbalit me datë 26.02.2020 me nr.88/20, pjesëmarrës në seancë në seancën dëgjimore të rastit Nafta ka marrë pjesë përfaqësuesi i paditësi “FAT OIL” SH.P.K.

20. Nga Njoftimi i fakteve paraprake të konstatuara në procedurë me nr.369/19 i datës 21.11.2019, Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se ndërmarrjet të cilat operojnë në tregun relevant (shitje me pakicë-naftë), nuk kanë reflektuar në mënyrë individuale marrë për bazë çmimin e shitjes dhe fitimin bruto për muajin Nëntor e Dhjetor. Që do të thotë se, ndërmarrjet të cilat janë në procedurë hetimore, kanë pasur fitim bruto përfaqësisht 9% për muajt Janar –Tetor, ndërsa për muajin Nëntor, në mënyrë të bashkërenduar kanë realizuar fitimin bruto mesatarisht 60% dhe për muajin Dhjetor 124%, ndërsa ka konstatuar se ndërmarrjet të cilat operojnë në tregun relevant (shitje me pakicë-benzine), nuk kanë reflektuar në mënyrë individuale marrë për bazë çmimin e shitjes dhe fitimin bruto për muajin Nëntor dhe Dhjetor, që do të thotë se ndërmarrjet të cilat janë në procedurë hetimore, kanë pasur fitimin bruto përfaqësisht 12%, për muajt

Janar-Tetor, ndërsa për muajin Nëntor, në mënyrë të bashkërenduar, kanë realizuar fitimin bruto mesatarisht 108% dhe për muajin Dhjetor 135%.

21. Paditësi "FAT OIL" SH.P.K., në komentet lidhur me njoftimin e AKK-së me nr.369/19-07/D të datës 21.11.2019, deklaron se si pjesëmarrës në tregun e shitjes së Benzinës me 1,07 % , dhe si pjesëmarrës në tregun e shitjes së Naftës me 0.96%, të precizuar në pikën II/1 në faqen 2 të Njoftimit të lartpërmendur të Autoritetit të Konkurrencës, nuk ka pasur, e as që ka mundësi që të çrregullojë tregun për Shitjen e Benzinës dhe Naftës, siç theksohet në Njoftimin të lartpërmendur, Shoqëria Tregtare " FAT OIL ", ShPK., nuk ka lidhur asnjë Marrëveshje (të definuar me dispozitat e nenit 3, par. 1, nën par. 1.1 të Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës) të ndaluar me ndonjë subjekt tjetër ekonomik, sipas dispozitave të nenit 4, par. 1 të Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, respektivisht nuk ka marrë pjesë në marrjen e ndonjë vendimi përmes Shoqatës, nuk ka bashkërenditur praktikën me subjektet tjera për të ndikuar me qellim, ose që të ndikoj në mënyrë të dukshme në çrregullimin e konkurrencës tregtare në tregun relevant, dhe nuk ka ndërmarre asnjë veprim, për të caktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi të Benzinës dhe Naftës, me çka vërtetohet se Shoqëria Tregtare " FAT OIL ", ShPK, nuk ka cënuar dispozitat e nenit 4, . 1, e lidhur me nën par.1.1 të Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, siç është konstatuar gabimisht në Njoftimin të lartpërmendur, Shoqëria Tregtare "FAT OIL" ShPK, si pjesëmarrës në tregun e shitjes së Benzinës me 1,07 % , dhe si pjesëmarrës në tregun e shitjes së Naftës me 0.96 % , nuk mund të konsiderohet se ka pozite dominuese në treg, të definuar sipas dispozitave të nenit 10, të Ligjit Nr. 03/L-129 për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi me dispozitat e par. 2 të këtij është përcaktuar se: Një ndërmarrje konsiderohet të ketë pozite dominuese nëse ka pjesëmarrje me të madhe se dyzet për qind (40%) në treg, bazuar në faktin jokontestues se vet Autoriteti Kosovar i Konkurrencës në Njoftimin e tij të lartpërmendur ka konstatuar se Shoqëria Tregtare " FAT OIL ", ShPK., merr pjesë në tregun për shitjen e Benzinës me 1,07 % , kurse me shitjen e naftës me 0.96 % , me çka vërtetohet se Shoqëria Tregtare " FAT OIL ", ShPK., nuk ka as mundësi teorike që të abuzoj me pozitën dominuese në treg, siç ka konstatuar gabimisht dhe pa baze ligjore Autoriteti Kosovar i Konkurrencës në Njoftimin e tij të lartpërmendur dhe se Shoqëria Tregtare

" FAT OIL ", ShPK., objektivisht nuk ka pasur si te abuzoj me Pozite dominues ne treg, pasi nuk ka disponuar me një pozite te tillë, për shkaqet e përmendura ne piken 1, 2 dhe 3 te kësaj parashtrese, me çka po ashtu vërtetohet se Shoqëria Tregtare " FAT OIL ", ShPK., nuk ka cenuar dispozitat e nenit 11 te Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, siç ka konstatuar gabimisht dhe pa baze ligjore Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ne Njoftimin e tij te lartpërmendur. Bazuar në gjendjen juridike dhe faktike te lartpërmendur, konsiderojmë se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për fillimin e procedurës hetimore ndaj Shoqërisë tregtarë " FAT OIL ", ShPK., sipas Konkluzionit te Autoritetit Kosovar te Konkurrencës, Nr. 40/19-02/D, te datës 15.02.2019, i cili gjendet në shkresat e lendes te këtij Autoriteti, kështu që për këtë arsyeje , Shoqëria Tregtare "FAT OIL", ShPK., përmes kësaj parashtrese kërkon qe Autoriteti Kosovar i Konkurrencës te pushoj hetimet ndaj kësaj Shoqërie Tregtare, te filluara sipas Konkluzionit te lartpërmendur.

22. Nga Njoftimi për konstatimin e gjendjes faktike nga AKK, me datë 31.01.2020 me nr.28/20, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, ka konstatuar gjendjen faktike sipas analizimit të dhënave, sjellja e ndërmarrjes FAT OIL SH.P.K., në tregun përkatës ka çrregulluar konkurrencën tregtare gjatë muajve Nëntor e Dhjetore të vitit 2018, e me këto veprime ka kryer shkelje të dispozitave të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencë Nr. 03/L -229 konkretisht neni 4 par.1 në paragrafi .1.1, “Marrëveshje e ndaluar apo praktikë e bashkërenduar”, ndërmarrja FAT OIL SH.P.K, në mënyrë të bashkërenduar/heshtur me ndërmarrje tjera, kanë caktuar çmimin e shitjes me pakicë të produktit naftë dhe benzinë për periudhën Nëntor e Dhjetor 2018.

Baza Ligjore

- 23. Ligji Nr. 04/L-226 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës Neni 2** 1. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1., nën paragrafi 1.1. riformulohet me tekstin si në vijim: 1.1. **Marrëveshje** - marrëveshjet e çdo forme, të lidhura ndërmjet ndërmarrjeve, me ose pa forcë detyruese, vendimet ose rekomandimet e grupimeve të ndërmarrjeve, **si dhe praktikat e bashkërenduara ndërmjet ndërmarrjeve**, të cilat veprojnë në të njëjtin nivel, ose në nivele të ndryshme, të tregut.

- 24. Ligji Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës (LMK) neni 4** përcakton marrëveshjet e ndaluara, paragrafi 1 përcakton *“Ndalohen të gjitha marrëveshjet ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve të pavarura, vendimet e marrura ne mes te shoqatave të ndërmarrjeve dhe praktikat e bashkërenduar të cilat kanë për qëllim ose mund të ndikojnë në mënyrë të dukshme në çrregullimin e konkurrencës tregtare në tregun relevant e veçanërisht marrëveshjet që”*: 1.1. caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;
- 25. Neni 56 i LMK-së** përcakton Masat Ndëshkuese për Shkelje të Rënda të Rregullave në Konkurrencën e Tregut paragrafi 1 parasheh se *“Masa ndëshkuese në një shumë deri në dhjetë përqind (10%) të totalit të të hyrave që ndërmarrja e ka realizuar në vitin e fundit për të cilin është përfunduar raporti financiar, ndëshkohet ndërmarrja nëse”*: 1.1. lidhë marrëveshje të ndaluar ose në ndonjë mënyrë tjetër merr pjesë në marrëveshjen me të cilën është çrregulluar konkurrenca, në mënyrën e përshkruar në dispozitën e nenit 4 të këtij ligji;
- 26. Neni 59 i LMK –së** përcakton Kriteret për Shqiptimin e Masave Ndëshkuese paragrafi 1 parasheh se *“Shuma më e lartë e masës ndëshkuese që mund të shqiptohet në bazë të këtij ligji në asnjë rast nuk duhet të tejkaloj shumën prej dhjetë përqind (10%) të totalit të të hyrave që ndërmarrja i ka realizuar në tri (3) vitet e fundit për të cilin është përfunduar raporti financiar, sipas nenit 56 të këtij ligji”* paragrafi 2 parasheh se *“Me rastin e shqiptimit të masës ndëshkuese Autoriteti i merr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese sipas peshës së shkeljes së veprës, sipas këtij ligji, kohëzgjatjes së shkeljes dhe pasojat e shkeljes për ndërmarrjet tjera në treg si dhe konsumatorët. Në këtë rast përdoret procedura e dyshkallëshe e përlllogaritjes së masës ndëshkuese administrativ në atë mënyrë që cakton bazën e shumës së masës për ndërmarrjen, atëherë shuma e përcaktuar zvogëlohet ose rritet në varësi të rrethanave lehtësuese ose rënduese”,* paragrafi 4 parasheh Rrethana lehtësuese të përcaktuara në paragrafin 2 . të këtij neni konsiderohen: 4.1. njoftimi i ndërmarrjeve për fillimin e procedurës nga Autoriteti, urgjentisht i dorëzon provat për ndërprerjen e veprimit të kundërligjshëm. Përgjashtimisht, në rastin e karteleve dorëzimi i provave për ndërprerjen e veprimit të

kundërligjshëm nuk do të konsiderohet si rrethanë lehtësuese; 4.2. dorëzimi i të dhënave për shkeljen e këtij ligji si shkak i pakujdesisë së ndërmarrjes; 28 4.3. dorëzimi i të dhënave që ndërmarrja edhe pse është pjesëmarrës i një marrëveshje të ndaluar, nuk e ka zbatuar atë marrëveshje, respektivisht edhe pse ka ekzistuar marrëveshja, ka vepruar në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e konkurrencës; 4.4. bashkëpunimi i ndërmarrjes me Autoritetin i cili i tejkalon detyrimet e ndërmarrjes për lirim ose zvogëlimin e masave ndëshkimore administrative, bazuar në këtë nen;

Vlerësimi i gjykatës

27. Pas vlerësimit të pretendimeve të përfaqësuesit të paditësit në seancë, pretendimeve të dhëna në padi, kundërshtimeve sipas përgjigjes në padi nga e paditura, si dhe në bazë të provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 43 dhe 44 të LKA-së, dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.
28. Gjykata vlerëson se e paditura ka iniciuar procedurën e hetimit konform nenit Neni 35 të **Ligji Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës**, të plotësuar dhe ndryshuar më **Ligjin Nr. 04/L-226 (LMK)**, ku përcaktohet se Autoriteti e fillon sipas detyres zyrtare procedurën e konstatimit të marrëveshjeve të ndaluara nga neni 4 i këtij ligji, si dhe procedura për konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese nga neni 12 i këtij ligji, dhe Neni 36 të **Ligji Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës**, e paditura me Konkluzion Nr.0119 datë 15.02.2019, ka filluar procedurës hetimore për shkak të dyshimeve të bazuara për çrregullim të konkurrencës në tregun e derivateve të naftës në kundërshtim me nenin 4 “Marrëveshje të ndaluar”, dhe nenin 11 “Abuzim me pozitën dominuese”, ndaj ndërmarrjeve të caktuara, përfshirë paditësin N.P.T. “FAT OIL”, SH.P.K.
29. Duke vepruar në pajtim me Neni 38 të LMK ku përcaktohet Mbledhja e të dhënave nga Autoriteti i autorizuar, e paditura ka mbledhur të dhënat e nevojshme, ndërsa me Njoftimin për faktet paraprake të konstatuara në procedurën paraprake, Nr. 369/19-07/D, i datës 21.11.2019, e ka njoftuar paditësin për faktet e konstatuara në procedurën

paraprake bazuar ne dokumentacionin e siguruara nga Dogana e Kosovës, ATK-se dhe paditësi, për shkeljet ligjore te pretenduara nga i padituri, si dhe e ka udhëzuar paditësin se ka te drejt te jep komente-përgjigje në këtë njoftim.

30. Gjykata i vlerëson të pabazuara arsyetimin e paditësit të dhënë ne njoftimin e AKK-së me nr.369/19-07/D të datës 21.11.2019, se paditësi “FAT OIL” SH.P.K., ka si pjesëmarrës ne tregun e shitjes se Benzinës me 1,07 % , dhe si pjesëmarrës në tregun e shitjes se Naftës me 0.96%, nuk ka mundësi qe te çrregulloj tregun për Shitjen e Benzinës dhe Naftës, dhe se nuk ka lidhur asnjë Marrëveshje te ndaluar me ndonjë subjekt tjetër ekonomike, nuk ka marrë pjesë në marrjen e ndonjë vendimi përmes Shoqatës, nuk ka bashkërenditur praktikat me subjektet tjera për të ndikuar me qellim, ose që te ndikoj ne mënyrë te dukshme në çrregullimin e konkurrencës tregtare ne tregun relevant, dhe nuk ka ndërmarre asnjë veprim, për te caktuar ne mënyrë te drejtpërdrejtë apo të tërthortë çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi te Benzinës dhe Naftës, sepse në kuptim të nenit në kuptim të *Neni 4 ku definohen Marrëveshjet e ndaluara 1. Ndalohen të gjitha marrëveshjet ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve të pavarura, vendimet e marrura ne mes te shoqatave të ndërrmarjeve dhe praktikat e bashkrenduar të cilat kanë për qëllim ose mund të ndikojnë në mënyrë të dukshme në çrregullimin e konkurrencës tregtare në tregun relevant e veçanërisht marrëveshjet që: 1.1. caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;* gjykata vlerëson se për të konstatuar përfshirjen e paditësit në praktikë me subjektet e tjera ekonomike, nuk është me rëndësi përqindja e pjesëmarrjes individuale në treg përderisa të gjitha subjektet ekonomike konkurruese që veprojnë në fushën e tregtisë shitjes së derivateve naftë dhe benzinë, kanë pjesmarje të konsiderueshme në një treg vendor që në rast të abuzimit me çmime të produktit rezulton me ngritje të çmimit të produktit në dëm të konsumatorit.

31. Gjykata vlerëson se për të ardhur deri të konstatimi se ndërmarrjet janë të përfshira në praktika të përbashkëta duhet të merren parasysh faktorëve të ndryshëm siç janë: *Sjellja paralele e konkurrentëve në një industri të caktuar që shfaqet me strategji të ngjashme tarifore, sjellje të tregut, apo praktika biznesi pa një shpjegim të arsyeshëm, mund të tregojë bashkëpunim ose veprim të përbashkët, shkëmbimi informacionit midis*

konkurrentëve në lidhje me çmimin, produktin, apo çështje të tjera të biznesit, që mund të përfshijë komunikimin e drejtpërdrejtë, apo edhe shkëmbimet e tërthorta nëpërmjet palëve të treta, Struktura e tregut gjeografik - tregu i përqendruar mund të ofrojë mundësi për bashkëpunim për shkak të presionit të reduktuar konkurrues, Analiza ekonomike që mund të përfshijë ndryshimin e çmimeve, profitabilitetin dhe faktorë të tjerë relevantë për të vlerësuar nëse veprimet janë është në përputhje me sjelljen konkurruese apo tregon bashkëpunim.

32. Në Bashkimin Evropian, përcaktimi i praktikave të përbashkëta përfshin një analizë të sjelljes midis bizneseve që edhe pse nuk arrijnë në mënyrë eksplicite një marrëveshje për të rregulluar çmimet apo për të kufizuar prodhimin, ende koordinojnë veprimet e tyre në një mënyrë që reduktoj apo çrregulloj konkurrencën, marrëveshje/praktika këto të ndaluara me Nenin 101 i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFEU).
33. Nga gjendja faktike e konstatuar, respektivisht sipas deklarimeve në procesverbal të datës 11.02.2020 të seancës dëgjimore të mbajtur nga AKK, përfaqësuesi i paditësit ka deklaruar se përcaktimi i çmimeve bë treg varet prej kërkesave në treg, dhe raporti në mes të ofertës dhe kërkesës e dikton që vlerën, dhe ka deklaruar se nuk i përcjellin çmimet në rajon por veten në treg ku i zhvillojnë aktivitetet. Nga këto rezultojnë se përfaqësuesi i paditësit nuk ka dhënë asnjë arsye të besueshme apo të argumentuar të një sjelljes paralele të ndërmarrjeve konkurrense në industrinë e naftës që shfaqet me rritje të çmimeve për periudhën kontestuese, me një strategji të ngjashme tarifore pa një shpjegim të arsyeshëm, madje pa dhënë një shpjegim se si përcaktimi i çmimeve pasqyrohet në ndonjë plan strategjik të ndërmarrjes.¹ Prandaj nga kjo praktike rezultojnë se të dhënat e analizuar tregojnë bashkëpunim ose veprim të përbashkët të paditësit FAT OIL SH.P.K., me subjektet tjera ekonomike procedurë të hetimit, duke vepruar në mënyrë të koordinuar në atë mënyrë që në muajin nëntor dhe dhjetor të vitit 2018 nuk

¹ Gjed n.w. rastin 48/69, *ICI v Commission* (Dyestuffs Case), 1972 theksoi që praktikën e bashkërenduar nuk kërkon një marrëveshje formale mes ndërmarrjeve për të qenë të paligjshme. Duke zgjeruar kështu kuptimin e bashkëpunimit të ndaluar midis konkurrentëve konkurrentet e tyre veprojnë bashkërisht në treg duke përfshirë çdo formë të koordinimit që zëvendëson konkurrencën me veprime të njohura të përbashkëta. Në këtë rast, Gjed vëmendje të veçantë i kushtoi mënyrës nga provat u vërtetua se vendimet e njëkohshme për ngritjen e çmimeve, së bashku me mundësinë e takimeve mes konkurrentëve përbënin prova të mjaftueshme për të mbështetur përfundimin se kishte praktika të bashkërenduar.

kanë reflektuar individualisht në uljen e çmimit të shitjes pavarësisht rënies së çmimit importues të produktit kanë realizuar fitim bruto të dyfishuar në raport me mesataren e fitimit bruto të realizuar gjatë muajve janar-tetor 2018, ashtu që për produktin naftë nga janar-tetor 2018 mesatarja e fitimit bruto/l ka qenë 0.08 cent/l ndërsa për muajin nëntor-dhjetor 2018 mesatarja e fitimit bruto/l ishte 0.17 cent/l. Gjate muajve janar - tetor ndërmarrjet përkatëse kanë pas një dallim të çmimit shitës nga çmimi blerës mesatarisht rreth 9% fitimi bruto/l. Gjate muajit nëntor krahasuar me mesataren e muajve janar - tetor, çmimi blerës/l rritet për 2.0% ndërsa çmimi shitës/l krahasuar me muajt janar - tetor është rritur për 7%, ashtu që mesatarja e fitimit bruto/l krahasuar me muajt janar - tetor është rritur për 60% në raport me fitimin bruto/l për periudhën janar - tetor. Ndërsa, gjate muajit dhjetor krahasuar me mesataren e muajve janar -tetor, çmimi janar-tetor 2018 ka rënie për 8% ndërsa çmimi shitës/l krahasuar me muajt janar - tetor ka rritje për 4% dhe mesatarja e fitimit bruto/l krahasuar me muajt janar - tetor është rritur për 124% në raport me periudhën e njëjte. Për produktin benzinë nga muaji janar- tetor 2018 mesatarja e fitimit bruto/l ka qenë 0.11 cent ndërsa për muajin nëntor – dhjetor 2018 mesatarja e fitimit bruto/i ishte 0.26 cent. Gjatë muajve janar - tetor ndërmarrjet të cilat operojnë në tregun përkatës kanë pas një dallim të çmimit shitës nga çmimi blerës mesatarisht rreth 12% fitimi bruto/. Gjate muajit Nëntor krahasuar me mesataren e muajve janar - tetor, çmimi blerës ka rënie për 5.0% ndërsa, çmimi shitës/l krahasuar me periudhën e njëjte është rritur për 7.0% dhe mesatarja e fitimit bruto/l krahasuar me muajt janar - tetor është rritur për 108% në raport me fitimin bruto/l për periudhën janar - tetor. Ndërsa, gjatë muajit dhjetor 2018, krahasuar me mesataren e muajve janar - tetor çmimi ka rënie për 12% ndërsa çmimi shitës/l ka rritje për 4% dhe mesatarja e fitimit bruto/l, krahasuar me muajt janar - tetor është rritur për 135% në raport me periudhën e njëjte.

34. Gjykata vlerëson se ndërmarrjet të cilat operojnë në tregun relevant shitjes me pakicë të produkteve të naftës dhe benzine përfshirë këtu edhe paditësin janë përfshirë në praktika të përbashkëta pa marrëveshje eksplicite gjatë muajit nëntor dhe dhjetor të vitit 2018, me një paralelizëm të ndërgjegjshëm, në kundërshtim Ligji Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës neni 4 (i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligji Nr. 04/L-226) përcakton marrëveshjet e ndaluara, paragrafi 1 përcakton “Ndalohen të gjitha marrëveshjet ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve të pavarura, vendimet e marra

ne mes te shoqatave të ndërmarrjeve dhe praktikat e bashkërenduar të cilat kanë për qëllim ose mund të ndikojnë në mënyrë të dukshme në çrregullimin e konkurrencës tregtare në tregun relevant e veçanërisht marrëveshjet që”: 1.1. caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi.

35. Gjykata vlerëson se sanksioni administrativ i shqiptuar është në përputhje me Udhëzimit Administrativ 01/2018, mbi Kriteret për Shqiptimin e masës së Sanksioneve Administrative, me nenin 4 par. 4, ku përcaktohet perioda e shkeljes së këtij ligji më e shkurt se 6 muaj Autoriteti e konsideron si gjysmë viti. Baza e ndëshkimit për periodhën kontestuese është marrë qarkullimi për gjashtë muaj, që është përcaktuar 3,372,330.19 euro dhe është aplikuar norma prej 3% në këtë bazë të ndëshkimit, dhe pas aplikimit të rrethanave lehtësuese është përcaktuar shuma në total prej 101,169.91 euro.
36. Prandaj, gjykata vlerëson se vendimi i kundërshtuar Nr. 35/2020 i datës 06.05.2020 i të paditurës Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, si autoritet kontraktues ka vlerësuar drejtë gjendjen faktike kur ka konstatuar se paditësi “Fat Oil” Sh.P.K. në bashkërendim me ndërmarrjet përkatëse kanë vepruar në kundërshtim me Ligjit Nr. 03/L-129 për Mbrojtjen e Konkurrencës të plotësuar dhe ndryshuar me **Ligji Nr. 04/L-226 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës**. Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Lidhur shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 63 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.345/22, datë 15.04.2024

Gjyqtarja
Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.